



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 41/18 Prot.

Koplik, më 07.06.2025

V E N D I M

NR, 16 DATË 30 / 05 / 2025

PËR

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Petre Dedë Brajoviq, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Petre Dedë Brajoviq nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 81 datë 31.12.2024 "për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afat mesem 2025-2027 të Bashkisë Malësi e Madhe".

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit z. Petre Dedë Brajoviq, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
2. Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile", në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2025 të miratuar me VKB. .81..date 31..12.2024 në programin "Perballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet në raste fatkeqesie".
3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Petre Dedë Brajoviq, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumën 100.000 (njeqind mijë) lekë , në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.81, datë, 31.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Malësi e Madhe ", nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 03280".

4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjorë të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për familjen e z **Petre Dedë Brajoviq**, në vlerën e dëmit nga ana ndertimore në shumen **580.950** (pesëqind e tetëdhjetë mijë e nentëqind e pesëdhjetë) lekë, 50% i saj është **290.475** (dyqind e nentëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) leke dhe elektroshtëpijake në shumen **197.700**(njëqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) lekë, ku 50% i saj është **98.850** (nentëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) leke .sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Malësi e Madhe. Vlera totale e dëmeve është **778.650** shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) leke ku 50% i saj është **389.325** (treqind e tetëdhjetë e nente mijë e treqind e njëzetë e pesë)leke
5. Ngarkohet administrata e bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumës prej **100.000** (njëqindë mijë) lekë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratur me 30.05.2025

Vota Pro 20

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 02.06.2025

